



ANRD

ALBANIAN NETWORK FOR RURAL DEVELOPMENT
RRJETI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN RURAL

Raporti Vjetor 2022

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural



RAPORTI VJETOR 2022| Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural

VIZIONI YNË

Vizioni ynë afatgjatë “Europa në Shqipërinë ruale” fokuson përpjekjet tona për t’u shndërruar në një aktor të rëndësishëm që shtyn përpara procese dhe reforma që avancojnë interesat dhe prioritetet e komuniteteve rurale dhe përshejtojnë këto procese drejt modeleve dhe praktikave pozitive evropiane për një Shqipëri me komunitete rurale të gjallëruara, përfshirëse, pjesëmarrëse, aktive dhe kontribuese për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës.

MISIONI YNË

Formësimi i një zëri të qartë, efektiv e të qëndrueshëm në mbështetje të komuniteteve rurale sipas filozofisë së zhvillimit rural të udhëhequr nga komuniteti.

PARIMET e promovuara nga ANRD janë të bazuara në praktikat e mira evropiane:

- Zhvillimi i qëndrueshëm rural social dhe ekonomik, me bazë territorin dhe veçantitë specifike të tij, duke aktivizuar komunitetet e mbetura pas në proceset e zhvillimit përmes qasjes nga poshtë-lart që fuqizon aktorët dhe rrit pjesëmarrjen e tyre;
- Qasja e integruar ndërsektoriale dhe shumëaktorësh në dobi të zhvillimit rural, përmes rrjetëzimit, shkëmbimit të përvojave dhe ndërtimit të partneriteteve lokale duke shfrytëzuar idetë inovative;
- Financimi dhe menaxhimi i projekteve lokale nga burime të ndryshme financiare si kontribut dhe konfirmim i kredibilitetit dhe rëndësisë së projekteve lokale.



“Të jesh një grua është e vështirë, të jesh një grua rurale është dyfish e vështirë dhe kjo gjë është vështirësuar edhe më shumë për shkak të pandemisë dhe tërmetit që preku Shqipërinë, prandaj ky projekt synon fuqizimin ekonomik dhe social të grave në zonat rurale.”

Angelica Ranieli, përfaqësuese e Agjencisë Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Edicioni IV 'Pro Grave Rurale' | 15 tetor 2022

Sot, vetëm 8% e fermave në Shqipëri drejtohen nga gratë, pavarësisht se ato luajnë rolin më të rëndësishëm në sektorin e bujqësisë. Gratë në zonat rurale përballen me diskriminime të ndryshme që kanë të bëjnë me pabarazi në vendimmarrje, stereotipe gjinore si dhe me ndarje të pabarabartë të kontributit dhe të punës së papaguar”, duke nënvizuar nevojën për angazhim të përbashkët për përmirësimin e mirëqenies së vajzave dhe grave.

- [Estela Bulku, Drejtuese e Programeve të UN Women në Shqipëri. Edicioni IV 'Pro Grave Rurale' | 15 tetor 2022](#)

“Nga pushteti qendror mund të dalin ligje të kulluara si uji i përroit, por ato turbullohen rrugës dhe ndaj sot kemi këto vështirësi. Të flasësh për gratë e zonave rurale duhet që fillimisht ta njohësh mirë realitetin. I bëj thirrje pushtetit vendor të ndërhyjë dhe të mbështesë grupet e grave rurale, të cilat fatmirësisht janë ekzistente, në formalizimin e aktivitetit”

- [Maria Frroku, përfaqësuese e grupit të grave Gjegjan, Pukë. Edicioni IV 'Pro Grave Rurale' | 15 tetor 2022](#)

“Egziston një problem shumë i madh: mungesa e të dhënave me bazë gjinore nga institucionet përkatëse dhe mungesa e formalizimit për gratë angazhuara në sektorin agri-ushqimor. Ne kemi një papunësi shumë të madhe në sektorin e bujqësisë kur në fakt gratë punojnë në bujqësi. Për shkak të problemeve me pronësinë e tokës, gratë nuk kanë mundësi të regjistrohen si të punësuar dhe kjo sjell një pabarazi shumë të madhe sepse ato nuk përfitojnë nga sigurimet shoqërore apo pensione.”

- [Enkeleda Olldashi, pedagoge në Fakultetin Juridik, Universiteti i Tiranës. Edicioni IV 'Pro Grave Rurale' | 15 tetor 2022](#)

“Nisma jonë është modeste, por ka në fokus të rinjtë e zonave rurale dhe një nga problemet më të mëdha në ditët e sotme, i cili është trendi gjithnjë në rritje i largimit të tyre nga zonat rurale duke vënë në rrezik jo vetëm qëndrueshmërinë e sektorit bujqësor dhe rural, por edhe jetës komunitare në fshat”.

- [Evelina Azizaj |Edicioni i 20-të i Ceremonisë së Çmimeve Flamuri i Gjelbër - Romë, 17 nëntor 2022.](#)

Reforma administrative-territoriale ka ndikuar në dobësimin e lidhjeve të komuniteteve rurale me qeverisjen dhe institucionet vendore duke thelluar përjashtimin dhe ulur aksesin ndaj informacionit dhe mundësive për zhvillim” –

[Evelina Azizaj](#), në seancën dëgjimore të Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë”.



Mesazh nga Koordinatorja Kombëtare

Të nderuar anëtarë të Rrjetit Shqiptar për Zhvillim Rural, kolegë, partnerë dhe mbështetës të punës sonë,

Ky raport prezanton shkurt punën tonë, momentet kyçe, partneritetet dhe çështjet kryesore të përpjekjeve tona përgjatë vitit 2022. Viti 2022 shënoi nisjen e një sërë nismash të përbashkëta me organizatat anëtare të ANRD duke nxitur ndërverprimin dhe forcuar kohezionin brenda Rrjetit. [‘Rinia Rurale Shqiptare’](#), ‘Ruralbania’, ‘Liqenet e Shqipërisë’, ‘Toka Jonë’ janë disa prej projekteve të përbashkëta që po zbatojmë me organizata anëtare të ANRD dhe partnerë të tjerë kryesisht duke nisur që nga 2022. Jemi të inkurajuar që duke nisur nga shtatori 2022, në sajë të rolit të ANRD si palë përgjegjëse për UN WOMEN Albania, të kemi intensifikuar përpjekjet për të krijuar solidaritet mbarëshoqëror për situatën jo të favorshme të grave dhe vajzave në zonat rurale. Vetëm për dy muaj (tetor-nëntor) kemi mundur me fushatën tonë të ndërgjegjësimit të arrijmë 10500 audiencë online dhe rreth 100 institucione në nivelin qendror dhe vendor. Gjithashtu, komuniteti i të rinjve në Qendrën e Rinisë Rurale po rritet, po njihet dhe po krijon marrëdhënie me struktura të konsoliduara të të rinjve në bujqësi dhe zhvillim rural edhe në vendet evropiane. Jemi të inkurajuar për dhënien e çmimit Flamuri i Gjelbër nga CIA-Agricoltori Italiani në nëntor 2022 dhe shpresëplotë se marrëveshja e bashkëpunimit me AGIA-CIA do të na ofrojë rrugë dhe mundësi të reja për t’u konsoliduar për të rritur ndikimin tonë.

Falë mbështetjes së UN Women Albania dhe GIZ Zyra rajonale në Shkup, kemi patur burimet e duhura për të mundësuar ofrimin e asistencës teknike për krijimin e Grupeve Vendore të Veprimit dhe hartimit të Strategjive të Zhvillimit Lokal në disa bashki të vendit: Elbasan, Kolonjë dhe Pogradec. Përvoja në zbatimin e ligjit për ngritjen dhe funksionimin e GVV-ve na ka ofruar mundësinë e modelimit të procesit të ngritjes së strukturave të partneriteteve vendore të tipit Leader.

Fare në fund, viti 2022 u përmyll me një sukses, që njëkohësisht prezanton edhe sfidën dhe përgjegjësinë tonë të madhe për vitet në vazhdim – firmosja e kontratës me Delegacionin e BE-së në Tiranë (në emër të Komisionit Evropian) për të zbatuar projektin katërvjeçar rajonal ‘Akademia nga Ferma në Tryezë për një Ballkan Perëndimor të gjelbër i. E ardhmja jonë Evropiane’. Projekti do të drejtohet nga ANRD dhe do të zbatohet nga konsorciumi i rrjeteve kombëtare të zhvillimit rural në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Kroaci në periudhën kohore Janar 2023 – Janar 2027. Përvoja dhe përpjekjet e deritanishme na kanë treguar se ende ka shumë për të bërë për zhvillimin e qëndrueshëm rural për të nxitur dhe përsheptuar reformat integruese drejt BE të këtij sektori kaq të rëndësishëm për ekonominë dhe demografinë e vendit tonë, dhe në veçanti për të përgatitur kapacitetet e shoqërisë për t’u përballuar me sfidat që po kërcënojnë sistemet e qëndrueshme ushqimore.

Në emër të anëtarësisë së ANRD, bordit dhe stafit dëshiroj të shpreh mirënjohjen dhe falenderime gjithë partnerëve, bashkëpunëtorëve dhe mbështetësve të punës sonë për inkurajimin, suportin dhe ndihmën e ofruar përgjatë gjithë vitit, pa të cilat nuk do të ishin të mundura arritjet sado të vogla të punës sonë.

Evelina Azizaj
Koordinatorja Kombëtare



SHIFRA DHE FAKTE 2022





AKTIVITETE 2022

Zhvillimi rural dhe bujqësor – Një perspektivë për të rinjtë nga AGIA-CIA. 21-24 qershor, 2022

Njëzet e pesë anëtarë të Rural Youth Hub (platforma e aktivizimit rinor të promovuar nga ANRD dhe të mbështetur përmes projektit Rural You) u mblodhën në Tiranë për t'u frymëzuar nga praktika të suksesshme evropiane në angazhimin e të rinjve në zhvillimin rural, për të shkëmbyer dhe diskutuar së bashku me të tjerë të rinj studentë në Universitetin Bujqësor të Tiranës, me z. Enrico Calentini, Zv. President i organizatës AGIA-CIA (Agia Giovani Imprenditori Agricoli) dhe zyrtarë të lartë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Duke marrë në konsideratë rolin e rëndësishëm të AGIA-CIA në sektorin bujqësor dhe rural në Itali dhe Evropë, ANRD në bashkëpunim me RTM organizuan disa aktivitete [për të dëgjuar përvojën unike të AGIA-CIA dhe për të shkëmbyer dhe diskutuar ndërmjet përfaqësuesit të AGIA-CIA-s](#) dhe të rinjve, studentëve, sipërmarrësve dhe entuziastëve të zhvillimit rural.

Gratë, artizanati dhe mirëqenia

Rreth 40 gra artizane, dhe të tjera që kanë interes të angazhohen në këtë sektor, u bënë bashkë më 27 korrik në aktivitetin rrjetëzues dhe shkëmbyes për mbështetjen ekonomike dhe fuqizimin e grave në Bashkinë Krujë në zinxhirin e vlerës së artizanatit. Takimi synoi të ndërgjegjësojë gratë pjesëmarrëse në grupin lokal në bashkinë e Krujës me alternativa dhe zgjidhje praktike për të adresuar problemet dhe sfidat me të cilat ato ndeshen. Një nga alternativat e diskutuara është edhe bashkëpunimi i grave dhe formalizimi i këtij bashkëpunimi. Përfaqësues nga Bashkia e Krujës, [Dhoma Kombetare e Zejtarije](#) dhe [Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural - ANRD](#) ndanë me gratë pjesëmarrëse perspektivën e tyre për të nxitur interesin dhe frymën e bashkëpunimit mes tyre për të krijuar një shoqatë lokale të grave artizane.

<https://ëëë.facebook.com/anrd.al/posts/pfbid02qyMMjk9U3HAQ3sgËX8ËFmKKGvjrzbb57nf5LkfkQ7KEZGtRz587x7HRTy9t1Ezhgl>

Trajnimi mbi fushatat marketing të produkteve artizanale dhe zhvillimin e biznesit për gratë artizane.

Në datat 12-13 korrik u takuam në Krujë me artizanet si dhe të tjera gra që kanë interes të angazhohen në punësim ose vetë-punësim në prodhimin apo tregtimin e produkteve artizanale në bashkinë e Krujës. Këtë herë për të realizuar kursin e trajnimit mbi fushatat marketing të produkteve artizanale dhe zhvillimin e biznesit për gratë artizane. Trajnimi u fokusua në zhvillimin e aftësive për të zbatuar fushata promovionale efektive, forcimin dhe rritjen e biznesit, komunikimi efektiv me klientët dhe besnikëria konsumatore; marketingu online , partneritetet mes vetë artizanëve dhe me institucionet, zinxhiri i bashkëpunimit të bizneseve B2B mes artizanëve dhe sipërmarrjeve turistike; standartizimi i produkteve.



AKTIVITETE 2022

Trajnimi mbi ruajtjen dhe përdorimin e resurseve tradicionale në bujqësi për zhvillimin e agro-turizmit

Gjatë muajve gusht – shtator 2023, ANRD organizoi në Radomirë tre sesione trajnimi dy-ditor me aktorët vendor të përfshirë në agroturizëm. Trajnimi i parë u fokusua mbi [ruajtjen dhe përdorimin e resurseve tradicionale në bujqësi](#) për zhvillimin e agroturizmit. Sesionet e zhvilluara synuan ndërgjegjësimin dhe motivimin e aktorëve vendor të përfshirë në agroturizëm dhe veçanërisht gratë dhe vajzat në zonën e Radomirës për t'u angazhuar në ruajtjen dhe përdorimin e resurseve tradicionale, të cilat ofrojnë mundësi të shkëlqyera për aktivitete të agroturizmit dhe fuqizimin ekonomik të tyre. Pjesëmarrëset u ekspozuan me modele dhe përvoja në fuqizimin social dhe ekonomik të grave në zona rurale përmes organizimit të grupeve lokale të grave në përpunimin dhe marketingun e produkteve lokale. Dy sesionet e tjera u fokusuan në tematikën e [Mikëpritjes dhe Turizmit në njësitë akomoduese të zonës](#) me sipërmarrësit, blegtorët dhe banorët e Radomirës. Trajnimi u fokusua në zhvillimin e produkteve turistike në zonat rurale duke ruajtur kulturën, traditën, vecantitë e territorit si në pjesën gastronomike ashtu dhe atë artizanale lidhur me elementët autentike (odat, kullat shekullore dhe shtëpitë mes maleve). Trajnimi i kushtoi një vëmendje të vecantë përfshirjes së grave dhe vajzave në sektorin e turizmit duke i afruar ato drejt shërbimeve më profesionale por edhe duke ruajtur shpirtin autentik. Synimi është përmirësimi i produktit ekzistues (guest house, bujtina, agroturizëm) dhe shërbimeve duke përfshirë elementët bazë të shërbimit në HORECA, sigurimin e një produkti gastronomik të pastër bazuar në normat e sigurisë ushqimore HACCP, përmirësimin e marketingut (përdorimin e rrjeteve sociale), komunikimit me klientin (teknikat e komunikimit dhe njohja me fjalorin e termave të shërbimit turistik në anglisht) duke siguruar së pari, sigurinë në punë.

Artizanati dhe mirëqenia e grave dhe vajzave në qendër të Panairit të Artizanatit. 27 gusht, 2022

Më 27 gusht, Bulevardi i Pishave të plazhit të Golemit u gjallërua dhe zbukurua nga ngjyrat dhe motivet e trashëgimisë sonë të pasur kulturore dhe tingujt e muzikës etno. [Panairi i Artizanatit](#) bëri bashkë dhjetra artizane nga Kavaja dhe qytete të ndryshme të Shqipërisë si Durrësi, Tirana, Elbasani, Vau Dejës, Berati, dhe Gjirokastra, të cilat ekspozuan produktet të prodhuara mjeshtërisht nga duart e tyre dhe tërhoqën vëmendjen dhe zgjuan kuriozitetin e të gjithë të pranishmëve.

Panari ofroi ëorkshope demonstruese të punës me dorë duke ftuar fëmijë, të rinj e të reja, të cilët nën kujdesin e artizaneve provuan të realizojnë procese të thjeshta të punës së dorës. Fëmijë të shumtë u bashkuan për të provuar magjinë e të krijuarit art me duart e tyre dhe u larguan të lumtur duke marrë e vete copëzën e artit që sapo krijuan. Panairi synoi promovimin e artizanatit si instrument i fuqizimit ekonomik të grave, rëndësisë së sektorit për turizmin, trashëgiminë kulturore dhe identitetin kombëtar dhe mirëqenies sociale dhe ekonomike të grave dhe vajzave. Gjithashtu, një ekspozitë modeste e fotografive të vjetra në lidhje me artizanatin dhe Kavajën krijoi një kënd tërheqës për shumë vizitorë.



AKTIVITETE 2022

“Pro-Grave Rurale” 2022 – Një thirrje për t’u zgjuar për eliminimin e pabarazive gjinore në sektorin agro-ushqimor. 15 tetor 2022 | Shirgjan, Elbasan

Edicioni IV “Pro-grave Rurale” 2022 me tematikën *Gratë rurale kultivojnë ushqim cilësor për të gjithë* vuri në qendër gratë që janë përfshirë dhe kontribuojnë në sektorin agro-ushqimor. Edicioni IV ofroi mundësi për t’u njohur me rolin dhe kontributin e paçmueshëm të grave në sektorin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, sigurinë ushqimore dhe zbutjen e varfërisë, duke i dhënë zë sukseseve dhe sfidave të sipërmarrëseve nga zonat rurale. Në komunitetin e vogël të Shirgjan vajza dhe gra nga zonat rurale të bashkive Kolonjë, Korçë, Elbasan dhe Pukë diskutuan mbi sfidat e tyre në sektorin agro-ushqimor. Për më tepër, ato kërkuan të ndërmerren veprime për të përmirësuar mirëqenien e tyre dhe për të pakësuar kufizimet që zvogëlojnë produktivitetin dhe potencialin e tyre sipërmarrës.

Shkëmbimi i përvojave ndërmjet grave artizane të Bashkive Kavajë dhe Krujë. 20 tetor, 2022

Në datë 20 Tetor 2022, Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural organizoi vizitën studimore me grupin lokal të grave përfshira në zinxhirin e vlerës së artizanatit në Bashkinë e Kavajës të cilat patën mundësinë të takojnë artizanet e Pazarit të Vjetër të Krujës. Vizita ishte njëditore dhe u krijoi mundësi grave artizane të Kavajës dhe Krujës të shkëmbejnë përvoja si dhe të përfitonin njohuri dhe aftësi të reja nga njëra-tjetra.

Dëgjese publike mbi modelin funksional të Grupeve Vendore të Veprimit (GVV) sipas qasjes LEADER.

Në tetor 2022, ANRD, me mbështetjen e IDM-së, organizoi dëgjesën publike në Përmet mbi modelin funksional të Grupeve Vendore të Veprimit (GVV) sipas qasjes LEADER. Aktiviteti synoi mobilizimin e vullnetit politik për të prioritetuar, mbështetur dhe nxitur zbatimin e qasjes LEADER, e cila ka potencialin të shndërrohet në një instrument shumë të rëndësishëm për fuqizimin e komuniteteve lokale dhe orientimin e tyre drejt një zhvillimi të integruar. Dëgjesa bëri bashkë 45 pjesëmarrës që udhëtuan nga bashki të ndryshme të vendit dhe që përfaqësonin nismëtarë dhe mbështetës të nismave vendore të tipit Leader nga sektori i biznesit, shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore, të cilët prezantuan nismat e tyre, diskutuan përvojat e tyre, problemet dhe sfidat që po hasin në ngritjen e GVV në komunitetet e tyre.



AKTIVITETE 2022

ANRD dhe RYH marrin çmimin Bandiera Verde në kategorinë AgriMED, Nëntor 2022 Romë-Itali.

ANRD dhe RYH morën pjesë në Edicionin e 20 të [Bandiera Verde](#), mbajtur më datë 17 Nëntor 2022 organizuar nga [Cia - Agricoltori Italiani](#) në [Campidoglio](#), Romë.

ANRD u vlerësua me çmimin Bandiera Verde seksioni AgriMED, duke dëshmuar punën e saj e bërë ndër vite në sektorin e fuqizimit të shoqërisë civile dhe zhvillimit rural në Shqipëri. Ky çmim, i cili jepet për sipërmarrësit për kapacitetet prodhuese dhe mbrojtjen e territorit dhe mjedisit, i dorëzohet ANRD-së në kuadër të bashkëpunimit dhe partneritetit në Projektin Rural You në seksioni Bandiera Verde Agricoltura - AgriMED i CIA - Agricoltori Italiani. Në vazhdim, delegacioni i Rural Youth Hub dhe Koordinatorja Kombëtare e ANRD morën pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis Agia, ANRD dhe RYH.

Workshopi mbi agroekologjinë dhe resurset gjenetike bimore lokale në Dvoran, Korçë

Në datën 8 dhjetor, Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural - ANRD zhvilloi në Dvoran, Korçë një [workshop mbi agroekologjinë dhe resurset gjenetike bimore lokale](#). Me ndihmën e AgriNet ALBANIA, ëorkshopi mblodhi njëzet fermerë në zonën e Dvoranit. Falë bashkëpunimit me Schola Campesina, Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural - ANRD po përpiqet të promovojë agroekologjinë dhe të lehtësojë shkëmbimin e njohurive lokale në lidhje me praktikën e agroekologjisë në nivel vendor, për të bërë në të ardhmen funksionale 'shkollën' e agroekologjisë – një shkollë pa mure dedikuar shkëmbimit të njohurive dhe praktikave ndërmjet fermerëve dhe aktorëve të tjerë. Ëorkshopi ndër të tjera shërbeu për të prezantuar dhe njohur me një nga Deklaratat më frymëzuese mbi agroekologjinë, të drejtat e fermerëve dhe prodhuesve të vegjël, komuniteteve rurale, etj., e cila njihet si Deklarata e Nyéléni.

Krijimi i Grupeve Vendore të Veprimit në bashkitë e Kolonjës dhe Elbasanit

Në kuadër të Projektit "Fuqizimi i grave në zonat rurale dhe turizmi" që zbatohet nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural në kuadër të projektit Barazi Gjinore Rurale dhe Turizëm (GREAT), i financuar nga Qeveria Italiane - AICS Tirana dhe zbatuar nga UN Women Albania and FAO, në bashkëpunim me [Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural](#), janë zhvilluar një sërë aktivitete për të prezantuar qasjen **LEADER** - një metodë e Bashkimit Evropian për mbështetjen e zhvillimit rural në nivel lokal me synim rigjallërimin e zonave rurale dhe krijimin e vendeve të punës.



AKTIVITETE 2022

Në Bashkitë Elbasan dhe Kolonjë, ekipi ANRD ka takuar më shumë se 100 banorë të komuniteteve vendore përmes **6 takimeve publike** të realizuara në kuadër të mbështetjes së procesit të zbatimit të Qasjes Leader dhe krijimit të partneriteteve vendore sikurse janë Grupet Vendore të Veprimit. Takimet prezantuan konceptin e qasjes Leader dhe sigurimin e angazhimit vendor në procesin e krijimit të GVV duke nxitur interesin, entuziazmin dhe motivimin e aktorëve kryesorë vendor, autoritete publike, sektori privat dhe shoqëria civile për të kontribuar në procesin ndërsektorial dhe shumëaktorësh që kërkon zhvillimi i qëndrueshëm i komuniteteve vendore.

Në Bashkitë Elbasan dhe Kolonjë janë organizuar **dy ditë informuese** për nxitjen e bashkëpunimit për zhvillimin e qëndrueshëm vendor, me fokus tek **fuqizimi ekonomik i grave dhe turizmi**. 128 aktorë vendorë, fermerë, të rinj dhe pjesëtarë të komuniteteve rurale, treguan interes të përbashkët për përfshirjen në procesin e krijimit/rivitalizimit të Grupeve Vendore të Veprimit.

Analiza e aktorëve të interesit në Bashkitë Elbasan dhe Kolonjë bëne bashkë rreth 45 përfaqësues nga autoritetet publike, operatorët ekonomike dhe social. Përmes këtij ëorshopi, pjesëmarrësit u njohën me: konceptin e partneritetit vendor për zhvillimin e qëndrueshëm territorial; verifikimin e kritetreve të këtij partneriteti sipas përcaktimeve ligjore si edhe rëndësinë dhe analizën e pjesëmarrjes aktive të aktorëve në GVV.

Workshopi rajonal “Roli i grave në zinxhirin e vlerës në sektorin agri-ushqimor në Ballkanin Perëndimor.

Në kuadër të përpjekjeve të FAO-s and Schola Campesina Aps për organizimin e katër webinarëve nënrajonale në Azinë Qendrore, Kaukazi e Jugut, Turqi dhe Ballkanin Perëndimor në 2022, gjatë muajit qershor ANRD organizoi [webinarin e dytë për rajonin e Ballkanit Perëndimor](#). Webinarin u fokusua në praktikat pozitive të fuqizimit ekonomik të grave në Ballkanin Perëndimor nëpërmjet zhvillimit të zinxhirit të vlerës me ndjeshmëri gjinore për sisteme të qëndrueshme agroushqimore. Webinarin shërbeu gjithashtu edhe për të nxitur diskutimin rreth rolit të Rrjeteve kombëtare rurale në promovimin e barazisë gjinore dhe agroekologjisë për sisteme ushqimore të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.



PUBLIKIME 2022

DEKLARATË PËR SHTYP RURAL YOUTH HUB, PLATFORMA E MBËSHTETJES SË AKTIVIZMIT RINOR NË ZONAT RURALE

Më 22 qershor 2022, 23 të rinj, anëtarë të Rural Youth Hub, nga zona të ndryshme rurale të Shqipërisë, entuziastë të zhvillimit rural organizuan takimin e pestë rrjetëzues dhe shkëmbyes, falë mbështetjes së projektit Rural-You, financuar nga Bashkimi Evropian.

[Deklarata u hartua me kontributin e të rinjve rural pjesëmarrës në programin "Zhvillimi rural dhe bujqësor - NJË PERSPEKTIVË PËR TË RINJTË NGA AGIA-CIA"](#) në kuadër të vizitës së Enrico Calentini zv. Presidenti i AGIA-CIA (Shoqata e Sipërmarrësve të Rinj Bujqësorë të Konfederatës Italiane të Fermerëve) në Shqipëri, nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural në bashkëpunim me Volontari nel Mondo-RTM. Programi dy-ditor ofroi mundësinë e duhur për të rinjtë për të dëgjuar përvojën unike të AGIA-CIA, për të shkëmbyer dhe diskutuar mbi sfidat e proceseve reformuese të sektorit, veçanërisht në përfshirjen e të rinjve për të luajtur një rol aktiv në përmirësimin e mirëqenies së komuniteteve rurale. Ky program inspiroi anëtarët e rinj të Rural Youth Hub për të shtuar përpjekjet dhe për t'i bërë ato konkrete përmes një plani konkret afatshkurtër për të formalizuar Rural Youth hub dhe për ta bërë atë një platforme funksionale dhe të qëndrueshme për të avancuar interesat dhe aspiratat e rinisë në zonat rurale.

REZOLUTË E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME E RRJETIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN RURAL". 23 SHTATOR, 2022

Më 28 qershor 2022 u mbledh Asambleja e përvitshme e ANRD për të vlerësuar punën dhe diskutuar progresin përgjatë vitit 2021 dhe diskutuar mundësitë dhe sfidat për 2022. Tridhjetë organizatat anëtare të Asamblesë së Përgjithshme të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin diskutuan dhe miratuan [Rezolutën Rilindja e komuniteteve rurale përmes jetësimit të qasjes LEADER në Shqipëri](#). Akademia e zhvillimit të integruar vendor "LEADER" – domosdoshmëri për të garantuar suksesin e zbatimit të zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti.



PUBLIKIME 2022

DEKLARATË E GRAVE DHE VAJZAVE TË KOMUNITETEVE RURALE. 7 NËNTOR, 2022

Gratë në zonat rurale janë aktore të rëndësishme në sektorin agro-ushqimor dhe kontribueset kryesore në sektorin bujqësor dhe rural. Megjithatë, sektori nuk po i ndihmon gratë rurale të përmirësojnë statusin e tyre social ekonomik për shkak të vështirësive dhe sfidave që ato përjetojnë, të cilët minojnë produktivitetin dhe potencialin sipërmarrës si dhe gjenerojnë përfitime të pabarabarta për burrat dhe gratë në zinxhirët e vlerës në sektorin agro-ushqimor.

Për të katërtin vit radhazi, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Grave Rurale, [Edicioni 'Pro Grave Rurale' 2022](#) mbledhi së bashku rreth 100 gra dhe vajza rurale për të diskutuar shqetësimet, prioritetet si dhe veprimet konkrete që duhen inkurajuar dhe ndërmarrë nga institucionet për mirëqenien e grave dhe vajzave në zonat rurale. [Deklarata është një thirrje për t'u zgjuar për eliminimin e pabarazisë gjinore në sektorin agro-ushqimor.](#)

MODELI FUNKSIONAL I GRUPEVE VENDORE TË VEPRIMIT SIPAS QASJES LEADER

[Ky dokument prezanton një përmbledhje të analizave, gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore](#) të punës të Rrjetit Shqiptar të Zhvillimit Rural përse i përket punës tematike me qasjen Leader në pesë vitet e fundit (2018-2022). E konsideruar një histori suksesi në zhvillimin rural në vendet e Bashkimit Evropian (BE), qasja LEADER ka potencialin të shndërrohet edhe për Shqipërinë në një instrument shumë të rëndësishëm për fuqizimin e komuniteteve lokale dhe orientimin e tyre drejt një zhvillimi të integruar.



PARTNERITETE 2022

Rrjeti Shqiptar per Zhvillim Rural është një organizatë e orientuar drejt partneriteteve që bashkëpunon me organizata dhe institucione të tjera partnere për të arritur ndikimin maksimal në qëllimet tona të përbashkëta.

MARRËVESHJA E PARTNERITETIT – PEOPLE IN NEED

Më 28-29 korrik, ekipi ANRD mirëpriti përfaqësuesit e People in Need në Kosovë në një ëorkshop dy ditor. Qëllimi i ëorkshopit ishte vlerësimi dhe [firmosja e marrëveshjes së partneritetit](#) si dhe diskutimi mbi projekt propozimin e përbashkët. Ky projekt do të ofronte një dritare mundësie për të forcuar partneritetin tonë dhe për të dhënë kontribut konkret në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri.

MARRËVESHJA E MIRËKUPTIMIT - AGIA GIOVANI IMPRENDITORI AGRICOLI

Bashkëpunimi i nisur me Cia - Agricoltori Italiani në kuadër të Rural Albanian Youth u kurorëzua me firmosjen e Marrëveshjes së Mirëkuptimit mes Agia Giovani Imprenditori Agricoli dhe Rrjeti Shqiptar per Zhvillim Rural. Marrëveshja synon forcimin e marrëdhënieve në sektorin bujqësor dhe rural, vecanërisht në lidhje me rolin dhe kontributin e të rinjve në sektor. Volontari nel Mondo RTM ka patur një rol të rëndësishëm dhe ka ofruar mbështetjen e pakursyer në konsolidimin e Rural Youth Hub dhe hapjes së perspektivave evropiane për shkëmbime dhe bashkëpunime të tilla të rëndësishme.



RRJETËZIM 2022


ANRD ka investuar në rrjetëzim në nivele të ndryshme si dhe ndërtimin e kapaciteteve të anëtarëve të vet në kuadër të dinamikave rajonale dhe evropiane të rrjeteve rurale dhe aktorëve të tjerë. Në këtë aspekt, përfaqësues të organizatave të ANRD dhe aktorëve të tjerë kanë marrë pjesë në aktivitete rajonale dhe evropiane.

ANRD dhe RYH marrin pjesë në edicionin V të Parlamentin Rural Evropian, Shtator 2022 Kielce, Poloni.

[Parlamenti i 5-të Rural Evropian u mbajt më 12-15 Shtator 2022 në Kielce, Poloni](#), me pjesëmarrje të më shumë se 350 përfaqësuesve nga 39 shtete të ndryshme. ANRD, si një nga 40 partnerët kombëtar të Parlamentit Rural Evropian (ERP), mori pjesë në ERP 2022 me një delegacion prej 3 të rinj përfaqësues të Qendrës së Rinisë Rurale, të cilët përfaqësuan në këtë event interesat dhe aspiratat e rinisë në zonat rurale të Shqipërisë. Të rinjtë përfaqësues sollën në këtë event problematikat që pengojnë zhvillimin rural në Shqipëri, por edhe diskutuan mbi praktikën e mira dhe zgjidhje të mundshme të sfidave duke marrë në konsideratë edhe përvojat e vendeve të tjera.

Programi i ERP përfshiu një sërë aktiviteteve si shkëmbim përvojash, vizita studimore, seanca diskutimi dhe evente për rrjetëzim të aktorëve të ndryshëm pjesëmarrës, me qëllim njohjen e përvojave pozitive në fushën e zhvillimit rural duke përfshirë krijimin e vendeve të punës në fshat, zhvillimin e sipërmarrjeve, prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve vendore, turizmin rural, kujdesin për të moshuarit dhe mbrojtjen klimatike.

MEDIA SOCIALE 2022



Page likes: 3.153 (445 new)
Page followers: 3,420 (633 new)



Femra 52% Meshkuj 48%

52% e ndjekësve të faqes janë femra ndërsa 48% e tyre janë meshkuj.

Pjesa më e madhe e ndjekësve të ANRD në Facebook i përkasin moshës 25-34 vjeç.



Grupmosha	13-17	18-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
% e ndjekësve	-	6.3%	38%	30.3%	14.7%	6.8%	3.9%

Periudha kohore	Viti 2021	Viti 2022
Lifetime Total Reach (Average)	984	1,165
Reactions	53.4	44.3
Shares	2.8	1.4
Comments	4.3	4.8
Post Clicks	63	30.3

633 ndjekës të rinj në 2022



MEDIA SOCIALE 2022



Ndjekësit e faqes së ANRD në Facebook jetojnë në 45 shtete të ndryshme. Pjesa më e madhe e tyre jetojnë në Shqipëri, Itali, Kosovë, Gjermani, Greqi, SHBA, Maqedoninë e Veriut, Kanada dhe Francë. Në rang vendi ndjekësit më të shumtë janë të vendosur në Tiranë, Shkodër, Përmet, Durrës, Korçë, Vlorë, Fier, Elbasan, Peshkopi e Berat.

Nëse për vitin 2021, postimi më popullor ishte Parlamenti Rural Shqiptar 2 i zhvilluar me 4 Mars 2021, me **9.8 K reach**, #ThursdayThoughts #ProGraveRurale Për Prof.Dr. Tatjana Dishnica më 8 dhjetor 2022, me **3,391 reach**, 187 reagime, 56 komente.

POSTIMET MË POPULLORE TË 2022:

- #ThursdayThoughts #ProGraveRurale Për Prof.Dr. Tatjana Dishnica (8 dhjetor, 2022) problemi dhe zgjidhja për fuqizimin e grave në zonat rurale janë shumë dimensionale – “Ka gra që ende kanë frikë ta ngrenë zërin dhe ne duhet t’i mbështesim që të mbrojnë të drejtat e tyre. Është e domosdoshme të bashkëpunojmë të gjithë, pushteti qendror dhe ai vendor së bashku me organizatat, për të fuqizuar ekonomikisht gratë dhe vajzat në zonat rurale.” **3,391 Reach, 187 reagime, 56 komente.**
- #ThursdayThoughts #ProGraveRurale (17 Nëntor 2022) **Cdo të thotë të jesh një grua rurale?** Valentina është një nga zërat më aktiv për problematikat e grave në komunitetet rurale të Korçës. Për të, “gratë rurale janë heroina të heshtura që punojnë 24 orë në punë të papaguar”. **2,431 Reach, 254 Reactions**
- #ProGraveRurale (15 Nëntor 2022) Faleminderit TOP ALBANIA RADIO, për hapësirën për të diskutuar dhe për të ngritur sadopak zërin mbi sfidat në nivel vendor të vajzave dhe grave në komunitetet rurale. Ju ftojme të na dëgjoni në bisedën në “Live from Tirana”, ku folëm për deklaratën e 90 grave nga zonat rurale të bashkive Elbasan, Kolonjë, Korçë dhe Pukë për **eliminimin e pabarazive gjinore në sektorin agro-ushqimor.** **2,237 Reach.**



MEDIA SOCIALE 2022

“RINIA SHQIPTARE RURALE – RURAL YOU!” 1 shkurt 2021 – 31 tetor 2023

Projekti synon të rrisë pjesëmarrjen e të rinjve në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike të komuniteteve rurale të Shqipërisë verilindore, përkatësisht në zonat e thella të Rajonit të Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës. Rezultatet e pritshme janë: i) Rritja e ndërgjegjësimit midis grupeve të synuara mbi rolin e të rinjve në reformën e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri; ii) Rritja e aktivizmit të të rinjve për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale të synuara; iii) Konsolidimi i platformës Rural Youth Hub si një përvojë pilot për të angazhuar të rinjtë që jetojnë në zona të thella në veprimet e rrjetëzimit dhe dialogun e politikave.

Rural-You është financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Volontari nel Mondo RTM, në partneritet ADAD Malore, AgroPuka, Partnership for Development Foundation, dhe Association of Young Agricultural Entrepreneurs - Italian Confederation of Farmers.

“Fuqizimi ekonomik i grave në zinxhirin e vlerës së artizanatit në Bashkitë e Kavajës dhe Krujës”

5 maj 2022 – 15 shkurt 2023

Ndërhyrja zbatohet nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural në kuadër të Projektit me Ndjeshmëri Gjinore për Rikuperimin dhe Rindërtimin pas Tërmetit, në bashkëpunim me Bashkitë e Krujë dhe Kavajës, financuar nga qeveria suedeze mbështetur nga UN Women.

Kjo ndërhyrje synon të mbështesë gratë, veçanërisht ato që gjenden në situata të vështira sociale dhe ekonomike, dhe të prekura nga dëmet e tërmetit të vitit 2019, të cilat angazhohen në punësim ose vetë-punësim në zinxhirin e vlerës së artizanatit në të dy bashkitë. Ndërhyrja do të krijojë për gratë e përfshira mundësinë e të punuarit së bashku në fushën e artizanatit duke siguruar zhvillimin e mëtejshëm të sektorit dhe kalimin e trashëgimisë tek brezi i ri i artizaneve, përmirësimin e proceseve të punës, rritjen e cilësisë, diferencimin dhe promovimin në treg të produkteve përfundimtare. Kohëzgjatja e projektit maj 2022 – shkurt 2023.

“Fuqizimi i grave në zonat rurale dhe turizmi” 5 shtator 2022-20 dhjetor 2023

Ky projekt financohet nga Qeveria Italiane dhe zbatuar nga UN Women Albania and FAO, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Projekti zbatohet nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural në rolin e palës përgjegjëse për UN Women Albania. Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin e situatës ekonomike të vajzave dhe grave në zonat rurale në bashkitë Elbasan dhe Kolonjë. Qasja që do të ndiqet në mbështetje të fuqizimit ekonomik dhe social të grave rurale do të jetë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi duke mundësuar formalizimin e Grupeve Lokale të Veprimit bazuar në praktikën më të mira evropiane në zbatimin e qasjes Leader. Zbatimi i suksesshëm i LEADER, zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti dhe zhvillimi i qëndrueshëm rural varet nga krijimi i një kuptimi të përbashkët mes palëve të interesuara rurale mbi zhvillimin e qëndrueshëm rural dhe të parimeve që qëndrojnë në themel të qasjes LEADER.



PROJEKTET 2022

“RURALBANIA: Nisma për mbështetjen dhe promovimin e produkteve bujqësore tradicionale për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale shqiptare” 1 shtator 2022 – 31 gusht 2025

RURALBANIA synon të rrisë të ardhurat e prodhuesve të vegjël bujqësorë në Shqipërinë e Veriut nëpërmjet aksesit në shërbimet e reja mbështetëse bujqësore në përputhje me praktikat më të mira evropiane, mundësitë për trajnime të kualifikuara profesionale, burime të qëndrueshme prodhimi dhe tregje vendase. Në mënyrë të veçantë, projekti synon të rrisë produktivitetin dhe vlerën e shtuar nga fermat malore në pronësi familjare, veçanërisht ato të drejtuara nga gra, të reja dhe migrantë të kthyer, që operojnë në zinxhirë furnizimi me potencial të lartë në Qarkun Shkodër, Dibër dhe Kukës.

Ruralbania financohet nga Agjencia Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nga Volontari nel Mondo RTM, në partneritet me CIA – Agricoltori Italiani, Rajoni Emilia Romagna, ADAD Malore, AgroPuka, Agjencia Rajonale Ekstensionit Bujqësor dhe Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural.

“LIQENET E SHQIPËRISË – Promovimi i modeleve të turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm për zhvillimin gjithëpërfshirës të komuniteteve” 1 gusht 2022 – 31 korrik 2025

Projekti synon të promovojë modele inovative të turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm në zonat që lidhen me dy liqenet kryesore të Shqipërisë - Liqenin e Shkodrës dhe Liqenin e Pogradecit/Ohrit - në krahasim me modelet e turizmit invaziv dhe zhvillimit në zgjerim të fortë në të gjithë territorin shqiptar, me qëllimin për të kontribuar në një rritje ekonomike gjithëpërfshirëse të Shqipërisë.

Projekti “LAGHI D'ALBANIA” financohet nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS) dhe po zbatohet nga Cosv dhe VIS në partneritet me Rrjetin Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD), Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT), Shoqatën Italiane për Turizmin e Përgjegjshëm (AITR), Diesis Netëork, Kallipolis, Studio Azue, në bashkëpunim me Fondacionin ABC dhe Fondacionin Partneritet për Zhvillim (Pfd).



PROJEKTET 2022

“TOKA JONË” – Ripërdorimi i tokave të konfiskuara për të promovuar bujqësinë sociale 1 janar 2022 – 30 shtator 2024

Toka Jonë financohet nga Komisioni Evropian dhe zbatohet nga një konsorcium i udhëhequr nga Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario (COSV), Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural (ANRD) dhe Consorzio LaRada, në bashkëpunim me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK). Projekti ‘TOKA JONË’ synon të forcojë sipërmarrjen sociale në menaxhimin e aseteve të konfiskuara nga organizatat kriminale bazuar në modelet e bujqësisë sociale. Qëllimi kryesor i ‘TOKA JONË’ është që të përcaktojë një model të bujqësisë sociale të qëndrueshme nëpërmjet trajnimit dhe punësimit të grupeve vulnerabël si dhe përfshirjes së komunitetit lokal në një sërë fushatash ndërgjegjëse.

‘Ekonomia e Gjellbër si një mundësi zhvillimi SMART për Radomirën’, zbatuar nga Bashkia Dibër në partneritet me Rrjetin Shqiptar për Zhvillimin Rural – është një projekt 6 mujor, financuar nga Programi për Zhvillimin Rajonal në Shqipëri, i cili ka filluar zbatimin në maj të 2022. Projekti synon të mbështesë fshatin Radomirë për të rritur konkurrencën e tij territoriale drejt promovimit të rritjes së qëndrueshme ekonomike. Objektivi i projektit është ofrimi i mundësive të reja për zhvillimin e ekonomisë lokale përmes zhvillimit të ekoturizmit në fshatin Radomirë si një mundësi për komunitetin e zonës. Projekti fokusohet gjithashtu në zhvillimin dhe promovimin e produkteve të reja turistike në fshatin turistik me përfshirje të drejtpërdrejtë të komuniteteve lokale.

Agroekologjia - ANRD ka qenë partneri kombëtar i Schola Campesina në Itali në përdorimin e TAPE – Mjet për Vlerësimin e Performancës Agroekologjike – që përfshin 12 vende të rajonit të Evropës dhe Azisë Qendrore të mbështetur nga FAO REU për të studiuar përvojat e agroekologjisë në nivel vendor. Falë këtij bashkëpunimi, ANRD po përpiqet të promovojë agroekologjinë dhe të lehtësojë shkëmbimin e njohurive lokale në lidhje me praktikatat e agroekologjisë në nivel vendor, për të bërë në të ardhmen funksionale ‘shkollën’ e agroekologjisë – një shkollë pa mure, pa infrastrukturë shkollore por që përmbledh aktivitete të shkëmbimit të njohurive dhe praktikave ndërmjet fermerëve dhe aktorëve të tjerë.



BUXHETI 2022

1 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022

TË ARDHURAT 2022

Të ardhurat	2022
Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit	35,000
Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare	
Të ardhura nga grandet qeveritare apo nga agjenci të tjera të financimit	39,660,915
Të ardhura nga investimet apo dhurimet	
Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara	<u>39,695,915</u>



BUXHETI 2022

SHPENZIMET 2022

Shpezimet për aktivitetet		
1	Materiale të imta	10,485
2	Energji ujë	193,973
3	Materiale ndihmesë	85,102
4	Nëntrajtime	667,274
5	Qera	470,570
6	Mirëmbajtje	18,000
7	Personel jashtë ndërmarrjes (t.b)	1,358,161
8	Pritje përcjellje, dreka etj	1,666,653
9	Udhëtim dieta	418,371
10	Poste, telefoni etj	589,790
11	Transport brenda vendit	189,500
12	Komisione bankare	20,550
13	Taksa e tarifa vendore	15,000
14	Shpenzime Paga Bruto	3,033,571
15	Shpenzime sigurime shoqërorë e shëndetësore Punëdhënës	316,752
16	Efektet e kursit të këmbimit	(168,931)
Totali i shpenzimeve		8,884,821